



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/395

Datë: 11.10.2018

PROCESVERBAL

i mbledhjes së II-të ( dytë ) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi në lexim të dytë të Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021

Mbledhja mbahet me datë 28.09.2018 dhe filloi në ora 18:20 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 24 asamblistë, Kryetari, Nënkryetari, drejtorë komunalë media dhe qytetarë.

**Rrahim Morina:** Përshendetje për të gjithë! E hapi mbledhjen e dytë urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës për vitin 2018 e cila mbahet në Sallën e Kuvendit në ora 18:20.

Pika e vetme e rendit të ditës sot është: Shqyrtimi dhe miratimi në lexim të dytë të Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021.

Sot KPF-ja ka mbajtur një mbledhje urgjente dhe është rekomanduar për leximin e dytë Projekt-Buxheti për vitin 2019-2021 të propozuar nga Kryetari i Komunës z. Ragip Begaj dhe Projekt-Buxhetin e propozuar nga tri grupet parlamentare PDK, LDK dhe VV. Materialet i keni marrur,

meqenëse unë dje kam dashur ta shpërndajë materialin por Kryetari në këtë drejtim më ka penguar. Faktikisht ka penguar edhe punën e Kuvendit për t'i furnizuar anëtarët e Kuvendit me material. Prandaj, jemi detyruar që sot në vazhdimin e sancës ta shpërndajmë materialin shtesë të cilin e kanë sjellë grupet e anëtarëve të Kuvendit PDK, LDK dhe VV. Një pjesë e kanë marrë materilain, një pjesë jo. Nëse do dikush materialin ai është këtu mund ta merrni. Atëherë kush është pro aprovimit të rendit të ditës?

Për: 17

Të lutem Avdi, jemi në procedurë të votimit. Ne jemi në leximin e dytë të buxhetit. Shumë të kjarët jemi. Ka ardhur propozimi tjetër i cili ka kaluar nëpër KPF e që është buxheti alternativ që grupet parlamentare kanë pasur të drejtë të bëjnë atë sepse ligji e lejon. Jemi në procedurë të votimit.

**Kryetari- Ragip Begaj:** Është mirë që të sqarohemi. A është leximi i dytë i Projekt-Buxhetit që e kam paraqitur unë, apo është leximi i parë i Projekt-Buxhetiti që keni paraqitur ju?

**Rrahim Morina:** Sot KPF-ja e ka rekomanduar edhe buxhetin alternativ të propozuar nga PDK, LDK dhe VV.

**Avdi Morina:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kryesuesi na ka fut në një qorrsoak që gjatë këtij procesi ne jemi duke bërë ndoshta edhe shkelje ligjore.

E kem një seancë që është vazhdimi e Projekt-Buxhetit të propozuar nga Kryetari i Komunës dhe në anën tjetër na keni pru një projekt propozim të grupeve parlamentare në mënyrë kandestine e që besoj që ka plot shkelje ligjore. Nuk po e kuptoj, pse ka me u hedh projekt-propozimi i Kryetarit në votim, kur ai është në votim?! Në qoftëse doni që pikën që po propozoni ju ta hedhni në votim, ajo është diçka tjetër, ju e dini që nuk keni të drejtë për një gjë të tillë. Ju po mendoni që me arrogancën e votave që janë shumicë e me na mbivotu, ajo është krejt diçka tjetër.

Kryesues, të lutem mos u bëjë pjesë e shkeljeve të venimeve të jashtëligjshme dhe të mos e shndërrosh Asamblenë në një arenë të diskutimeve joprofesionale e as morale e as etike.

Ne e përkrahim vetëm propozimin që ka ardhur prej qeverisë sepse ashtu e parasheh edhe ligji. Çdo mënyrë tjetër që po mundoheni të thirrni është e jashtëligjshme. Të gjitha këto nryshmine në



buxhet ju është dhënë mundësia që t'i fusni në Projek-Buxhet. Kjo mënyrë nuk është e mirë dhe do t'i dëmtojë qytetarët dhe keni nxitë një lloj lufte ndërmjet grupeve politike të panevojshme. Ne ju kemi orfuar të gjitha mundësitë, jeni takuar drejtpërdrejt me drejtorin e Financave dhe i keni dhënë propozimet e juaja. Diçka tjetër është që po mendomi tek fuqia e votës e jo gjithëmonë ajo ju çon në një rrugë të drejtë. Është mirë që të ulemi dhe t'i bëjmë ato ndryshime në buxhet e ta votjmë buxhetin e Kryetarit e të mos dalim qesharak.

**Rrahim Morina:** Më duket që unë e bëra të qartë:

a. Shqyrtimi dhe miratimi në lexim të dytë të Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021 dhe

b. Projekt-buxheti i propozuar nga grupet parlamentare PDK, LDK dhe LVV

KPF-ja sot në mbledhje urgjente i ka rekomanduar të dy këto buxhete.

**Arbëreshë Krasniqi:** Përshendetje për të gjithë! E keqe është për mua dhe për krejt qytetarët që nuk po kemi se çka të dëgjojmë. Kastriot, ty dhe disa të tjerë nuk kam qef t'ju shoh në këso situatash sepse disa nga familjarët e juaj kanë kaluar edhe sfida me të rënda dhe i kanë dhënë kuptim jetës dhe shtetndërtimit dhe jo me ardh në këtë nivel dhe me u bërë temë mediatike Malisheva me ide dhe çështje të cilat aspak nuk na bëjnë nder dhe as nuk kanë mbështetje ligjore.

E para. I nderuari Kryesues, ne jemi në një situatë që nuk i bënë nder Malishevës e as Asamblesë, e as ty si Kryesues.

E dyta. Idetë e funksionimit të KPF-së që 1 vit janë në bazën e shkeljeve ligjore dhe kjo është shumë e keqe.

E treta. Të gjithë ata të cilët vijnë me idenë që vota dhe shumica e votave e përcakton edhe me të keqen e kanë gabim, sepse kjo nuk është ide e cial an çon përpara dhe është përfituese, por është ide degjeneruese dhe është në dëm të qytetarëve.

Jemi në një situatë që Kryesuesi i Kuvendit ka thirrë mbledhje urgjente, e di që ka të drejtë ekskluzive, ne e kemi respektuar dhe kemi ardhur këtu dhe por e respektojmë Asamblesën në të gjitha format me gjithë ato shkelje që po bëhen dhe prap se prap NISMA është këtu. Jemi duke diskutuar për një çështje që qytetarët e Malishevës me padurim presin investimet dhe mjetet e tyre

të cilat i kontribuojnë këtij vendi që ne duhet t'i japim kuptim të mirë e jo kuptim të diskutimeve të cilat nuk janë të nevojshme.

Kryesues, nga praktikat e kaluara ky është buxheti i 5-të dhe asnjëherë nuk e kam dëgjuar e as nuk e kemi përjetuar këtu një propozim si sot. Kemi pasur zëra, mospajtime, kërkesa por të gjitha bazën e kanë pasur që të involvohen dhe të inkurporohen në kërkesën që e ka sjellur Kryetari i Komunës dhe qeveria komunale. Këto alternativa nuk janë të suksesshme.

Kryesues, ke thirrur seancë urgjente e që e ka kuptimin e një pike të rendit të ditës e që është pika e Kryetarit. Sot ke mbajtur KPF-në në kuptimin urgjent, cila ka qenë thirrja e asambleistëve tanë që mbahet KPF-ja në nivelin urgjent? Paske sjellë rekomandim nga KPF-ja të cilin unë nuk e kam parë dhe po kërkon që të hyjë edhe kjo pjesë alternative e buxhetit.

Kastriot, Alban dhe Hashim dëgjova që ke punu shumë për atë buxhetin alternativ, përshendetje për punën që keni bërë, asgjë të keqe nuk ka. Në emër timin dhe të grupit kërkoj që të gjitha kërkesat të cilat i keni paraqitur në Projekt-buxhetin alternativ do të doja që involvohen në Projekt-Buxhetin që ka paraqitur Kryetari i Komunës dhe nga ne do ta keni mbështetjen e fuqishme sepse për mua kudo që shkojnë investimet s'ka problem sepse shkojnë për qytetarët e Malishevës. Kryesues kërkoj që ky propozim i imi të hidhet në votim dhe e keni mbështetjen tonë dhe kështu do të merr kuptim edhe kjo seancë që do t'i jep vulë investimeve në K. e Malishevës.

**Rrahim Morina:** Kam një sqarim për Arbreshën. Me Statut të Komunës edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale thuhet që Kryesuesi e thirr mbledhjen e rregulltë, të jashtëzakonshme dhe urgjente në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës. Unë jam konsultuar me Kryetarin rreth kësaj çështje dhe Kryetari në momentin kur ka marrë vesh edhe për buxhetin alternativ që do të jetë në rendin e ditës dhe shqyrtimit të tij ka reaguar dhe nuk ka krijuar kushte, ka thënë që nuk kemi të drejtë. Ne kemi shumë të drejtë sepse Kuvendi e miraton buxhetin, prandaj në KPF ne e kemi shqyrtuar dhe i kemi rekomanduar dy projekt-buxhete edhe të Kryetarit por pika e veteme e rendit të ditës do të jetë: Shqyrtimi dhe miratimi në lexim të dytë të Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021. Opozita në leximin e parë ka dhënë vërjetjet, kërkesat dhe sugjerimet por që nuk ka paraqitur materialin, por në leximin e dytë e ka ofruar materialin e protokoluar. Ky material është shqyrtuar dhe është rekomanduar si:



a. Shqyrtimi dhe miratimi në lexim të dytë të Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021 dhe

b. Projekt-buxheti i propozuar nga grupet parlamentare PDK, LDK dhe LVV

pra, ky është rendi i ditës për sot. Urdhëro Hashim dil propozoje se këta po kanë qef kështu.

**Hashim Vrenezi:** Përshëndetje për të gjithë! Unë dëgjova këtu shumë zëra që po shkelet dhe s'po shkelet ligji. Ne nuk po e dimë se ku është shkel, le të del dikush dhe le ta vërtetojë që është shkelur. Kur dikush po e shkel po ballafaqohet me gjykatën me vite të tëra dhe në fund ndoshta po shpallet i pafajshëm, prandaj mos u ngutni të thoni u shel apo jo ligji sepse nuk po e dimë këtë.

Në mbledhje urgjente nuk duhet të ketë debat jashtë rendit të ditës realisht, e këtu nuk ka filluar as mbledhja e nuk e di pse duhet me dal e të debatohet para se me fillu mbledhja. Le të fillojë mbledhja, dalim e bëjmë debatin rreth buxhetit. Shumë qartë Kryesuesi po e thotë që është leximi i dytë i komunës sonë për vitin 2019-2021. Gjatë leximit të dytë janë edhe propozimet tona krahas propozimeve të qeverisë e që nuk është asnjë shkelje. Ne kemi bërë edhe vërejtjet tona dhe apsolut Qeverisja Begaj nuk na është përgjigjur në vërejtjet që i kemi bërë. Gjatë hartimit të buxhetit kjo qeverisje asnjëherë nga grupet politike opozitare nuk e ka thirrur në konsultim me hartu buxhetin e Komunës për vitin 2019-2021. Jemi 18 asambleistë që jemi pjesë e këtij Kuvendi dhe nuk e dimë se ku kanë për të shkuar investimet e komunës sonë. Ky hap neve na shtyrë drejt përpilimit të buxhetit alternativ të opozitës për t'i pasur të qarta investimet. Ne me këtë buxhet kemi punuar bashkarisht opozita dhe substanca e buxhetit është e njëjtë dhe ajo që e dallon prej buxhetit të propozuar nga Kryetari janë ato specifikat të cilat neve na bëjnë të qartë se ku po shkojnë investimet dhe me mund që të monitorohen investimet përgjatë këtyre viteve. Absolutisht nuk ka asgjë kundërshtim me buxhetin e juaj ose që ka ndonjë interes partiak. Ky buxhet është për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës. Besoj që shumica e asambleistëve edhe të pozitës pajtohen që ky buxhet i plotëson kriteret e buxhetit që e jep një pasqyrë të analizës. Ne nuk i kishim informatat që i keni ju sepse sigurisht do ta përpilonim edhe më mirë dhe kishte me nxjerrë konkluzione më të mira, por me këto informacione që kemi pasur ne jemi munduar të bëjmë një specifikim të buxhetit e që është i qartë. Fillojmë me rendin e ditës me debatimin e dy projekteve dhe në fund i hedhim në votim të dyja buxhetet dhe cilido që kalon ne jemi në rregull.



Pra, ne propozojmë që të hyjë në rendin e ditës edhe buxheti i propozuar nga opozita. Nëse ka shkelje ligjore ne ballafaqohemi me ligjin.

**Rrahim Morina:** Ju lutem përgatituni për votim!

**Arbreshë Krasniqi:** Rendi i ditës nuk guxon të paraqitet me dy kërkesa sepse përndryshe grupi i NISMA e lëshon sallën. Është kërkesa e Kryetarit në vazhdimsi, përndryshe jeni duke bërë shkelje ligjore.

**Kryetari- Ragip Begaj:** Të gjitha komunat e Kosovës mirtaajnë buxhet, dua që ne të mos dalim qesharak.

Hashim t'i mundësh me qenë më i mençur, por unë jam Kryetari i Komunës. Ndoshta profesionistë shumë më të mirë, por unë e kam paraqitur këtë buxhet që ne kemi ditur ta paraqesim, pavarësisht mangësive. Që të dalim nga kjo situatë kërkoj nga ju që t'i futni të gjitha ato kërkesa që mendoni që nuk kanë qenë në buxhet. Por rruga të cilën ju e keni ndjek është e gabueshme. Vetë formulimi i rendit të ditës është për mbledhje urgjente e ndaç thuani të jashtëzakonshme e karakterin e një pike të rendit të ditës dhe ajo duhet decidivisht sipas asaj pike të rendit të ditës dhe asgjë tjetër jo. Çfardo që shtoni në këtë pikë të rendit të ditës nuk është në rregull.

Një ditë do të vdes edhe unë dhe do t'ju bie ndër mend të gjithëve që keni gabuar me sjellje ndaj meje dhe ndaj shumë veteranëve të tjerë dhe ndaj atij vendimi që keni marrur sot. E kuptoj Rrahimin shumë mirë sepse me mund ai veteranët nuk i le në Kosovë hiç, i largon jashtë Kosove edhe dëshmorët i heq nga varrezat, por ju s'po e kuptoni.

Këtë që po e bëni ju sot për buxhetin, dijeni që është gabimi i juaj. Unë nuk dua që të gaboni as ju e as unë. Urdhëroni, i keni votat dhe bëjeni atë që po ju merr mendja juve! Nëse ju doni të më dëgjoni dhe të më respektoni mua sepse jam munduar që të mos gaboj kurrë dhe nuk do doja që të gaboni as ju, urdhëroni dhe qitni në letër gjërat dhe futeni idetë, projektet e juaja në Projekt-buxhet të cilin e kam propozuar unë.

Është mirë që të mos bëhemi hora e vendit sepse nuk kemi nevojë! Nuk jam duke kërkuar asgjë për vete këtu. Unë i kam ndjekur të gjitha rrugët ligjore për miratimin e buxhetit. Kanë qenë debatet publike që ishin të domosdoshme dhe të obliguara dhe i kanë dhënë mendimet e veta

qytetarët. Pastaj buxhetin e kam dërguar edhe në KPF edhe pse e di se si i kemi raportet, por unë e kam kryer obligimin tim ligjor. Tash, me dal diçka tjetër këtu, Hashim nuk e ke në rregull?!

Ju lutem mos fyeni sepse Kuvendin e shoh si vend i debateve dhe i qëndrimeve, projekteve dhe ideve të mira! Unë po kërkoj mirëkuptim nga ju! Dua që Malisheva të dalë mirë! Unë nuk po e heq as një pikë dhe asnjë presje që ju e keni bërë, por mos e kundërshtoni propozimin tim. Propozimi i juaj ka ardhur me shkelje ligjore. Kastriot, nuk ka kaluar nëpër dëgjime publike.

Kryesues, je duke shkelur parimet e Kuvendit, mos sepse nuk i bënë nder me punën tënde as vetës e as bashkëpunorëve të tu! Unë jam kundër nëse ti fut buxhet alternativ në Kuvend. Unë ju kam hapur derën juve urdhëroni dhe futni ato propozime të juaja dhe të dalim unik në buxhet. Jam i vetmi unë që kam autoritet që mund të propozojë buxhetin para Kuvendit. Nëse unë ju kisha ndaluar juve që mos t'i fusni kërkesat e juaja, atëherë keni pasur të drejtë të bëni këtë.

Komiteti për Politikë dhe Financa kërkon nga Kryetari për t'a çuar në Kuvend buxhetin. Shikojeni rrugën ju të cilën e keni ndjekur. Kryetari kërkon nga KPF-ja me çu buxhetin në Kuvend, jo KPF-ja nga Kryetari. Të gjitha këto janë shkelje. Urdhëroni dhe futni kërkesat e juaja në në buxhetin që kam propozuar unë dhe që ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, votoni këtë me plotësimet e juaja. Kjo është zgjidhja. Ju nuk jeni autoriteti që keni të drejtë të propozoni buxhetin.

**Rrahim Morina:** Kryetar, po bjen në pozicione shuëm të palakmueshme. Kërkesën për vetëranët e ka sjellë Komiteti i Familjeve të Dëshmorëve.

Ju lutem që qytetarët të lirojnë sallën sepse nuk kanë të drejtë të flasin! Salla duhet të lirohet përndryshe nuk vazhdon mbledhja!

Ju lutem uleni nëpër vende! Ju lutem shkoni nëpër vendet e juaja! Kjo është sjellje e pahijshme e qeverisë sepse drejtorët nuk kanë të drejtë të flasin!

**Kryetari- Ragip Begaj:** Kuvendi nuk është vendi me u tregu se kush është më i forti. Këtë e kërkoja edhe në fillim. Kuvendi është vendi ku debatohet për çështje, ide dhe projekte më të mira. Po ju drejtohem juve më të rinjëve. Koha e trimërisë ka përfunduar. E kemi parë se kush ka qenë trim. Mosni, trimëri nuk shitet në Kuvend! Këtu shtin ide, projekte dhe fjalë të mira! Keni kujdes, kjo hiç s'po m'pëlqen! Mosni, nëse dikë e fyen, nuk fitoni më shumë! Nëse ju dikë e bindi me ide të mira, kjo është fitorja juaj!



Kryesues, dua që mos ta teproj kurrë. Gabim e ke thirrur mbledhjen urgjente. Gabim e je duke e futur në rendin e ditës dhe gabim je!

Pse e keni këtë inati ndaj meje?! A keni diçka personale?! Urdhëroni dhe bëjeni atë që kërkova e të dalim unik të gjithë sepse rruga e Projekt-buxhetit që kam sjellë deri këtu nuk ka shkelje ligjore, këtë e kërkoj nga ju.

**Rrahim Morina:** Ju lutem, respektojani disa rregulla! Kryetar, po më vjen keq sepse nuk dua të lëshohem në ato fjalë të ulëta që fol pa mbështje, pa argumente dhe pa fakte. Kërkesa ka qenë e Komitetit të Familjeve të Dëshmorëve dhe shoqatave të dalura nga lufta. Propozimi i tyre ka qenë edhe më i keq, por unë kam kërkuar në Kuvend që të votohet vetëm të ndërprehet varrosja, pastaj kemi shkuar në konsultim të gjitha grupet politike dhe teksti është hartuar nga grupet politike dhe është lexuar nga Alban Mazreku dhe është votuar. Prandaj nuk është mirë të flasësh kështu sepse ti nuk mund të jesh më kombëtar se unë për këtë jam shumë i bindur. Kur të doni mund të masim edhe historitë familjare edhe personale dhe i hapim dosjet personale dhe familjare dhe shihet se kush është kombëtar aty. Ju nuk ma keni dhënë librezën pse kam qenë LDK edhe pse është dashur sot ta kem në xhep. Ju nuk ma keni dhënë sepse unë kam fakte dhe dëshmi. Nuk dua të lëshohem më shumë në këto gjëra sepse fatbardhësisht jam shumë i pastër. Ju lutem, qeveria komunale nuk ka të drejtë që të reagojnë! Është Kryetari këtu dhe ky është shefi i tyre. Drejtorët nuk kanë të drejtë të reagojnë në punën e këshilltarëve të Asamblesë Komunale.

Sot Kryetari nuk e ka lejuar Naimin të vije në mbledhjen e KPF-së ka mbetur pa u shtypur rekomandimi dhe me u përcjellë në Kuvend. Nëse doni mund të shpallë një pauzë 10 minutëshe dhe e shtypim rekomandimin dhe e biem këtu.

Atëherë shkojmë në votim ju lutem! Njëherë shkojmë në votim për rendin e ditës: Shqyrtimi dhe miratimi në lexim të dytë të Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021

a. Projekt –Buxheti i propozuar nga Kryetari i Komunës z. Ragip Begaj


b. Projekt-Buxheti i propozuar nga grupet parlamentare PDK, LDK dhe LVV, ju lutem kush është për?

**Arbëreshë Krasniqi:** Ne duke llogaritur se po bëni shkelje ligjore dhe ju garantoj që kjo ka për të përfunduar si shkelje ligjore. I lus të gjitha anëtarët e grupit të NISMA që ta lirojnë sallën.



(Asamblesitet e NISMA, Qeveria Komunale dhe zyrtarët administrativ largohen nga salla e mbledhjes)

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

  
**Nebih Bibaj** : Duhet me definuar ketë punën e administratorëve, a janë të Kuvendit, a janë të Kryetarit, nëse janë të Kuvendit ne duhet me u bë bashkë e me i paditë, nëse janë të Kryetarit le t'i merrë t'i dërgon ku të dojë, po nëse janë të Kuvendit duhet me nejtë këtu.

**Rrahim Morina**: Dëgjoni vetëm një çështje, unë kam luftuar gjatmonë që Kuvendi me pasë stafinë e vetë dhe tashmë e kemi shti në këtë, dhe nga viti 2019 janë tre zyrëtarë të stafitë të zyrës së Kuvendit, por për momentin këta janë punëtorë të administrates së përgjithshme, prandaj ky i urdhëron padrejtësishtë. Vazhdojmë me rendin e ditës, urdhëro Hashim Vrenezi paraqite një ekspozite të buxhetit për vitin 2019-2021 me theks të veçantë për vitin 2019.

**Hashim Vrenezi**: Përshëndetje kolegë për të gjithë! Besoj kjo sjellje e qeverisjes Begaj është e papranushme për të gjithë, unë mendoj që nuk kemi nevojë për situata të tensionimit dhe besoj që qeverisja Begaj duhet me na siguru në Kuvend, e jo me ardhë qytetarët me na kërcenu duke krijuar një situatë të konflikteve direkte. Meqë qeverisja Begaj nuk gjendet këtu, ne nuk kemi nevojë të debatojmë rreth projekt-buxhetit të propozuar nga qeverisja Begaj. Ne partitë opozitare pasë vërejtjeve që i kemi bërë, kemi vërejtë që ata nuk kanë interes me pas bashkëpunim në hartimin e buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2019-2021, dhe ky hap neve na ka shty që ne si parti opozitare të tri grupet PDK, LDK, LVV, me u ul me hartu një buxhet për qytetarët e Komunës së Malishevës pa dallime partiake, klanore, grupe, ky buxhet ka një shtrirje në tërë Komunën, e në gjitha fshatrat, dhe mendojmë që i plotëson të gjitha kriteret e një buxheti. Strukturën e buxhetit e kemi rrujt të kategorive ekonomike që janë: Pagat dhe meditet, mallra shërbime, komunal, subvencione, investime kapitale. Një sqarim për të gjithë qytetarët, ndoshta votuesit e Nismës që munden më qenë të shqetësuar që ne kemi bërë ndonjë diskriminim në këtë aspekt, unë ju them që ky buxhet është veç më i mire sesa buxheti i qeverisjes Begaj, sepse ai ka



qenë një buxhet jo i specifikuar dhe i ka dhënë hapësirë ndoshta të manipulojë dhe adresojë aty ku ka vota ai, e jo aty ku është shumica e qytetarëve. Në këtë buxhet të gjitha janë të specifikuara, në emër fshati, lagje, rrugë, metra, thjeshtë qeverisjen Begaj kemi me mujtë me monituar më mire, sesa me buxhet e propozuar nga ta. Kemi bërë disa dallime konkrete, ndoshta isha lëshuar pak në aspektin e zërave buxhetorë, të pjesa e bashkëfinancimit me qytetarët me projektet e infrastrukturës buxheti total është 50.000€, të pjesa e bujqësisë një dallim prej buxhetit të qeverisjës Begaj, ne kemi ndarë disa zëra buxhetorë që janë në kuadër të bujqësisë dhe të cilët prekin kategori punëtore, konkrete dhe nuk i japin hapësirë qeverisjes të shprehajnë multikultivatorë, makina mjelëse, stërpikëse, të cilat kanë vlerë të vogël të financimit thjeshtë janë një spërkatje e qytetarëve për t'i manipuluar për votë. Ne jemi lëshuar në financimin e fermerët me fara dhe plehra, për fermerët të cilët nuk hynë kategorinë e subvencionimit nga qeveria, që i bije më pak se dy hektar, ne kemi ndarë 50.000€, për t'i subvencionuar. Pastaj kemi një shumë prej 40.000€ në ngritjen e serrave, 40.000€ për ngritjen e pemishtëve, një shumë për konsolidim të fermave prej 40.000€, subvencionim i ndërmarrjeve prodhuese bujqësore prej 50.000€, furnizimi më mekanizma bujqësore 20.000€ dhe subvencionimi i fermërve me makineri bujqësore-traktorë që nuk ka qenë më herët. Nuk mendoj që kemi nevojë të specifikojmë konkretisht fshat për fshat, lagjet e të tjera. Buxheti i është propozuar edhe qeverisjës Begaj, në fakt ne kemi dashur t'a protokolojmë dje, por qeverisja na ka penguar protokolimin, poashtu edhe thirrjen e mbledhjes urgjente, ne sot e kemi bërë këtë, ne na ka mbetur ta hedhim në votim buxhetin e konsoliduar nga partitë opozitare në këtë Kuvend. Faleminderit për fjalën.

**Kastriot Berisha** : Faleminderit Kryesues, përshendetje asambleistë të nderuar. Me të vërtetë është një rast i veçantë, Kuvendi Komunal në Malishevë është mandati i dytë, siç e dimë të gjithë, është duke e keqpërdorë paranë publike edhe më herët por tentuan edhe tash qeverisja Begaj. Qytetarë të nderuar të Komunës së Malishevës, vetëm një sqarim shumë të vogël, shikone një projekt-buxhet që e ka sjell qeverisja Begaj, shikone një projekt-buxhet që është sjellë nga tri partitë opozitare PDK, LDK, LVV. Kjo qeveri tregon se ka ndarë mbi 20.000€ për printera, në mandatin e kaluar, ndërsa sot nuk bënë asnjë printerë sepse nuk ka fletë, Komuna nuk ka pas buxhet dhe prandaj nuk ka fletë me printu. Atëherë ne i'u bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës, që është miratuar një buxhet prej partive opozitare, i cili është buxhet për qytetarët e Komunës. Sepse buxheti të cilin e ka sjell qeverisja Begaj ai buxhet është për



pushtetarët, ka mbi 1,500,000€ shpenzime që as vet nuk e dinë për çfarë shpenzime. E ne asambleistat asgjë nuk kemi bërë me shumë, vetëm se ato shpenzime të cilat këta i kanë ndarë për pushtetarët e vetë, ne i kemi futur në investime si në bujqësi, rrugë, kanalizime, infrastrukturë e shëndetësi, mbi të gjitha ky buxhet nuk ka asnjë vërejtje, saqë as partia në pushtet nuk mundi me gjetë, dhe prandaj e lëshojë sallën. Buxheti është i dedikuar më së shumti për Arsim, shëndetësi dhe bujqësi, e jo për shëtitje e për me shku në deti na, sikur këta që po udhëtojnë për Turqi e i kanë bë miliona euro shpenzime tjera, e kur i pyetëm se çfarë shpenzime tjera ata nuk dinë se çfarë dhe rrinë t'u përta mes veti ai pse Drejtor, ai pse Kryetar. Andaj kjo parti e Nismës që e ka vetëm një Komunë të fituar në gjithë Kosovën edhe del e thirret bastioni i Nismës Malishevë, këta janë asambleistët që i treguan Kryetarit e drejtorëve të Nismës që këtu nuk është bastion i nismës, por është bastion i qytetarëve të Komunës së Malishevës, nuk është bastion i asnjë partie. Ju urojë dhe i përgëzojë qytetarët e Komunës së Malishevës për një buxhet ndoshta është i vetmi buxhet prej mbasë luftës që është bërë dhe është përpiluar për qytetarët e jo për një parti politike, urime qytetarë të Komunës së Malishevës e gëzofshi, dhe do të i'a sjellim çdo fshati çdo qytetari këtë buxhet që të shoh se çka kemi propozuar ne këtu, çka kemi futë në këtë buxhet, e qeverisja Begaj është ajo e cila mos t'a realizojë, se nuk na vjen qudi, 90.000€ i ka Kryetari të cekura për gjykata, ku i ka dërguar, në gjykata e avokatë. Ne nuk kemi lënë pare që Kryetari me i shfrytëzuar për gjykata, por i kemi futë në investime të cilën do t'a vërtetoni edhe ju vetë. Drejtorja e Arsimit në vitin e kaluar i ka pasë 50.000€, ku me shkuar kur 40 e ca shkolla i ka Komuna e Malishevës me 50.000€, nuk kemi mundur më shumë por 150.000€ i'a kemi ndarë, sepse e meritojnë fëmijët se i ka nga 45 nxënës klasa e parë. I keni parë postimet në facebook çka është shkolla "Ibrahim Mazreku" është për t'u tmerruar. Urime qytetarë të Komunës së Malishevës e gëzofshi, urime.

**Valon Krasniqi** : Përshendetje për Kryesuesin, përshendetje për asambleistët. Së pari më lejoni të kërkojë falje, për të gjitha aksidentet që ndodhën, poashtu kërkojë falje edhe për ata që më kanë votuar, mirëpo unë do i premtojë dhe i kam premtuar se ndoshta ndonjëherë do të dal prej vetës, por me mua asesi nuk do të ketë kompromis e keqja e vendit. Sa i përket grupit parlamentar të LDK-së, ne kemi shqyrtuar të dy propozimet, projekt-buxhetin që Kryetari po e quanë projekt-buxhet të vetin për arsye, se me ne asambleistat nuk është koordinuar fare dhe poashtu kam hasur në keqpërdorime, janë lënë anash shumë prioritete dhe shumë fshatra,



sidomos fshatrat që janë më malor. Ne si shumicë kemi ardhë në përfundim duke e paraqitur një projekt-buxhet alternativ opozitarë që përfshinë tri subjekte dhe qytetarët duhet ta dinë mirë se tri subjekte në këtë rast mendojnë që ideja e tyre kur përputhet është më e mire, prioritetet dhe të gjitha realizimet kapitale paraqiten më mire. Unë dhe grupi jonë parlamentar unanimitë e përkrahim këtë projekt-buxhet sepse është dukshëm më i mirë se projekt-buxheti i propozuar nga Kryetari Begaj, unë i urojë qytetarët e Komunës së Malishevës, urime sepse më të vërtetë do të jeni të kënaqur me projekt-buxhetin sepse është bërë nga profesionistë, dy ekonomistë që në këtë rast dua ta falenderojë Alban Krasniqi e Hashim Vrenezi që kanë punuar në këtë projekt-buxhet. Urojë që edhe qytetarët të jenë të kënaqur me projekt-buxhetin që jemi munduar t'a përpilojmë në mënyrën më të mire të mundëshme dhe ligjore. Urime.

**Hidajete Mazreku:** Faleminderit Kryesues, përshendetje kolegë asambleistë! Pasi që kemi në shqyrtim dhe miratim buxhetin për vitin 2019, unë besojë që ky buxhet është shumë i dedikuar për qytetarët. Kalojë drejtpërdrejtë tek buxheti të cilin e kemi përpara, buxheti i opozitës, ose i tri partive që janë këtu në Kuvend, PDK, LVV, LDK, i përgëzojë shumë që për një kohë të shkurtër kanë përpiluar një buxhet shumë të dedikuar për të gjithë qytetarët, në të gjitha zërat buxhetore janë të përfshimë, të gjitha kodet që i përkasin buxhetit për shqyrtimin e tij ose për kalimin e tij, këtu kanë vepruar në të gjitha mënyrat e veprimit, për këtë arsye i përgëzojë për punën e palodhshme që kanë bërë ekonomistat, juristat në lidhje me krijimin e këtij buxheti. Sepse edhe buxheti duhet të këtë edhe ligje edhe specifikatë e veta, unë posaqërishtë i'u drejtohem qytetarëve të Malishevës se në këtë buxhet janë përfshirë të gjitha fshatra, asnjë fshat nuk ka mbetë pa u specifikuar, lagje vend, fusha apo ku ka qenë e nevojshme që të bëhen investime janë cek në buxhet. Projekt-buxheti i përpiluar nga këto tri parti ka një rëndësi të madhe për qytetarët e Malishevës, bujqësia është një sektor i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së Komunës. Në tërësi janë përfshi të gjitha kategoritë që krijojnë zhvillimin. Mos të hamendën qytetarët e Malishevës duke thënë se ky nuk është buxheti i Kryetarit, sepse ne i kemi ofruar një buxhet më të mirë sepse edhe ne i përkasim Komunës së Malishevës. Urime qytetarë, nuk do të zhgënjehëni kurrë, ju që na keni votuar, për ju punojmë.



**Nebih Bibaj** : Përshendetje për të gjithë asambleistë, qytetarë që jeni t'u na përcjell pëmes facebook-ut privat live, sepse Komuna na e tërhjeki zyrtarinë që duhet të jetë këtu. Ky buxhet është në shërbim të qytetarëve dhe i'u ka prek në çdo lagje, çdo fshat. Se po i'u thamë drejtë e kemi pas një buxhet që e ka pas Komuna, Kryetari Begaj, por ai buxhet nuk i'u ka prek dhe nuk e ka lehtësuar gjendjen e juaj ku ju banoni. Buxheti jonë i tri partive opozitare ndihmonë të gjitha pikat, kemi intervenuar në kabinete të shkollave për lëndë natyrore të cilat këta nuk i kanë parapa, kemi intervenuar në fusha sportive të cilat ata nuk i kanë parapa. Ne ju garantojmë që ky buxhet do të rregullojë mirëqenjen e juaj qytetarë dhe në të njejtën kohë i'u them urime se ky është buxhet i juaji. Faleminderit!

**Alban Mazreku** : Përshendetje Kryesues, të nderuar asambleistë, të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës. Mua po më vjen keq tash që Avdi Morina nuk është këtu në asamble, të cilët e lëshuan sallën pa asnjë motivë të caktuar, desha t'i them Avdisë se sjelljet e tij në qytetin e Malishevës si një fare lloj i pa prekuri vjen me një audi të Ministrisë, dhe shëtitet në qytet me drita vezulluese audi Q7 dhe i njejtë vjen e na krition neve, po më vjen keq që i'a përmenda emrin e nuk është prezent këtu, po më qenë i kisha thënë edhe diçka tjetër. I nderuar Kryesues buxheti i propozuar nga PDK,LDK,LVV është një projekt-buxhet i cili është i shtrirë në gjithë territorinë e Komunës së Malishevës, propozimi që ka dal nga opozita e bashkuar në Kuvend i prek pothuajse të gjitha fshatrat, të gjitha rrugët, e shumë lagje duke u nisur nga qyteti i Malishevës, në gjitha fshatrat ku parasheh edhe investimet kapitale. Unë mbasi jam edhe në cilësinë e Kryesuesit të Komitetit për Shëndetësi, gjatë vizitave që i kam bërë me anëtarët e tjerë të LDK-së e LVV-së nëpër këto insititucione shëndetësore poashtuajse shumicën e kërkesave të tyre i kemi inkorporuar në këtë projekt-buxhet duke u nisur nga shtëpia e shëndetit për një autoambulancë, pastaj shtëpia e shëndetit në Kijevë, për një makinë të nevojave të shtëpisë shëndetit. Diçka tjetër që kemi fut në buxhet e që nuk ka qenë në projek-buxhet nga qeveria Komunale është edhe instalimi ose vendosja e një lifti në shtëpinë e shëndetit ku do t'i krijojë mundësi gjithë të moshuarve dhe të sëmurëve të palëvizshëm që të bëjnë vizita përveç në katin e dytë edhe në të tretin të shtëpisë shëndetit. Avdia na akuzojë pa emra disa asambleistave gjoja ne kemi pas kontakte me Drejtorin e financave, po i tham Avdijes unë rri me Drejtorin e financave rri me Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës me çdo Drejtor të Kuvendit Komunal, me çdo qytetarë e qytetare të Komunës së Malishevës sepse unë jam i Malishevës, dhe askush nuk



mund të ma ndalojë me kënd rri e me kënd bisedojë. Unë du me falenderu Valonin që kemi pas bashkëpunim, mirëpo buxheti të cilin e kanë propozuar këta ka qenë i mangët. Nëse ndalemi në qytetin e Malishevës për investimet për vitin 2019-2020-2021 janë këto projekte përafërsisht: Rregullimi i rrugëve nga ura kryesore që qonë të rruga e mini-transitit nga të dy anët e shtratit të lumit Mirusha, është ndriçimi publik në të gjitha lagjet e Malishevës, kanalizimi në të gjitha lagjet si dhe në lagjen Mirdita dhe lagjen e Re në Golesh janë trotuarët. Malisheva në vitin tjetër në 2019 do t'a kompletojë infrastrukturën rrugore, trotuarë, kanalizimin si dhe rrugë me këtë buxhet të propozuar nga opozita në Komunën e Malishevës. Kemi parapa edhe ndërtimin e shumë fushave të sportit nëpër shkolla të fshatrave të Komunës së Malishevës, poashtu kemi parapa edhe paisjen me kabinete rreth 8-9 shkolla, kabinete jo vetëm për sy e faqe, por paisje me kabinete të informatikës, fizikës dhe kimisë. E tha edhe Kastrioti që asamblea e vitit të kalumë me një buxhet të propozuar nga partia në pushtet Nisma ka planifikuar një shumë solide për vitin 2018, vetëm 50.000€ për renovimin e shkollave, ndërsa ne e kemi marrë kërkesën shumë saktë drejtorit të Arsimit z. Blerim Thaçi, ku shumën nga 50.000€ e kemi rritë në 150.000€, e kemi marrë edhe një kërkesë të Blerim Thaçit ku ka parashikuar për veteranët e arsimit për të vizituar Shkollën Shqipe në Shqipëri, ku kemi ndarë një shumë prej 10.000€. Qytetarët i urojë për këtë projekt-buxhet dhe kërkojë nga asambleistët e PDK-së, LDK-së dhe LVV-së që ta miratojnë këtë buxhet me votë unanime, faleminderit shumë.

**Ali Morina:** Faleminderit Kryesues, përshendetje të nderuar asambleistë. Sinqerisht unë e ndjejë vetën keq për arsye që nuk janë mjetet e zërimit për t'a parë qytetarët transmetimin e kësaj seance kaq të rëndësishme për qytetarët e Komunës së Malishevës, por sa i përket projekt-buxhetit mua më gëzon fakti që idea e grupeve asambleiste që kanë propozuar buxhetin kanë qenë kaq transparente saqë. Çerdhja është propozuar që të ndërtohet në Kijevë, ndërsa nga qeverisja Begaj është propozuar që të ndërtohet në Banjë, është e qytetarëve që ta vlerësojnë rëndësinë se a është më mire në Kijevë apo në Banjë. Dhe fakti tjetër që mua më ka lënë përshtypje në këtë buxhet është ndarja e mjeteve për renovimin e lapidarëve nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës, kur e dimë gjendjen e tyre të mjerushme, ku gjithë subjektet politike thirrën në emër të vlerave të luftës ndërsa nuk kanë parapa asnjë cent për mirëmbajtjen e tyre. Faleminderit Kryesues.



**Valon Krasniqi:** Kërkojë falje që këto që do t'i specifikojë nuk i paskna cek më herët, vlenë të theksohet që në projekt-buxhetin e ekzekutivit edhe pikat që i kemi miratuar në seancat e kaluara nuk janë përfshirë fare psh propozimi i një nga asambleistave këtu, që ceket financim për kujdesin shëndetësorë në familje dhe për nevojat e nënave me fëmijët e sapolindur dmth nga 100€ për çdo lindje, ne jemi dëshmitarë që kjo është votuar në asamblenë komunale. Sot vjen Kryetari dhe na thotë ne që nuk ka gabime të theksuara, mendoj që është thyrje e rregullave, fare nuk e ka mirëfillë një miratim të Kuvendit. Gjë që projekt-buxheti opozitarë ka qenë më i koordinuar, sepse ne jemi fokusuar edhe në kategoritë e dalura prej luftës; rregullimi i vend ndodhjes së maskarës së Burimit, ndërtimi i qendrës për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së, renovimi dhe mirëmbajtja e lapidarëve të dëshmorëve në tërë Komunën e Malishevës. Me të vërtet më këtë projekt-buxhet që unë kërkojë që të votohet unanimitë nga të gjitha grupet parlamentare mendoj që qytetarët do të jenë mjaftë të kënaqur.

**Hashim Vrencezi:** Kërkojë falje që po marrë kohë, vetëm deshta me i sqaruar disa gabime teknike në kalkulime që kanë ndodh, psh te faqja 1 e pjesës së investimeve kapitale në fshatin Panorc është në kllapa dhe është e specifikume, po këtu ku është Panorc edhe metrat tjera të kanalizimit nuk duhet të jetë 500m po duhet të jetë 1300m ne kemi bërë korigjimet për këto që jemi duke folur tash, dhe i kam dorëzuar Kryesuesit katër kopje, është faqja 3 të toruarët në Malishevë, rruga Ilaz Agushi nuk e ka kapë hapësira kur është printuar dhe ka mbetë pa u vërejtë 500m, të ndërtimi i rrugëve me kubëza. menjëherë pas saj është një gabim teknikë për shkak që brenda kllapave janë të specifikuara në secilin rrugë dhe lagje metrat e rrugëve me kubëza që kanë shkuar atje edhe këtu është 1500m por duhet të jetë 1700m. Është Ngucati i cili ka brenda kllapave 220 dhe 200 që bëjnë 420, por është një gabim teknikë dhe del 620, dhe është fshati Astrazup në të cilin është dashur të shënohen 1300m asfaltë por janë shënuar 500m, dhe është fshati Mleqan i cili brenda kllapave i ka të specifikuara metrat por kur është shënuar ka dalur 400m e që duhet të jetë 650m. Këto ndryshime që i specifikova janë të korigjuara dhe Kryesuesi i ka kopjet e tyre, faleminderit.



**Rrahim Morina:** Faleminderit Hashim, shumë mirë bërë që e sqarove këtë çështje, unë e kam marrë edhe kopjen e përmirësuar mirëpo pjesa tjetër i ka pa përmirësime. Është mirë këto të evidentohen edhe në procesverbal, që të mos ketë mosmarrëveshje masandej. Nëse më lejohet po i them edhe unë nja dy fjalë dhe pastaj po e hedhim në votim, nëse nuk ka diskutues. Të nderuar anëtarë të Kuvendit më të vërtetë është një buxhet që është hartuar mirë dhe ka përfshirë të gjitha fshatrat dhe gjitha korat e jetës që qytetarët kanë për t'i kryer nevojat e veta. Është një buxhet që krijonë mirëqënie për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës, si në Arsim, shëndetësi, kulturë, mbrojtje të ambientit, infrastrukture, kanalizime, ujësjellës, është një projekt-buxhet i cili po e them më shumë përgjegjësi i ka ndarë disa gjëra që më të vërtetë kanë shkuar në damë të qytetarit të Komunës së Malishevës. Në projekt-buxhetit e Kryetarit figuronte po e marrë vetëm një shtyllë thoshtë: shërbimet e tjera kontraktuese 128.000€ që nuk e ka ditur çka janë ato. Prandaj ne e kemi ndërprerë të keqen e këtyre shërbime kontraktuese tjera pa e ditur se ku po shkojnë, tek ne në buxhet është e specifikuar çdo gjë prandaj kemi punuar më tepër në ndërtimin e cilësisë nëpër shkolla që faktikishtë kanë munguar deri tash, ku shkollat do të paisen me kabinete, po jo vetëm shkolla se kemi krijuar kushtet për një jetë më të mirë për qytetarët e Komunës së Malishevës, si në trotuarë, rrugë të asfaltuar, kanalizime e gjëra tjera. Mua më vjen keq që ndonjëherë kjo qeveri po e humb arsyjen, Kuvendi është ai i cili vendos për buxhet. KPF-ia i ka rekomanduar të dyjat ne i kemi rekomadimet, Kryetari propozon por Kuvendi është ai i cili voton, ne i kemi zbatuar procedurat ligjore, mos u shqetësoni në këtë çështje. Unë vetëm mund t'i përgëzojë qytetarët e Komunës së Malishevës se vërtetë është një buxheti i cili ka me i plotësuar kërkesat dhe nevojat e tyre me aq kushte dhe para sa ka pas në buxhetin e qeverisë, dikun 14,347,979,00€. Urime e i gëzofshi këto investime, faleminderit.

**Rrahim Morina:** Të nderuar të pranishëm, anëtarë të Kuvendit, e dini që në rend të ditës është edhe projekt-buxheti i Kryetarit të Komunës, mendimi im është ta hedhi në votim edhe atë, sepse ne jemi Kuvend, pavarësishtë asaj që ata dolën ne duhet të veprojmë sipas ligjit, kuorrumin e kemi, por votimi duhet të vërtetohet. Kush është për aprovimin e a.)projekt-buxhetit të propozuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës Ragip Begaj?

Për: 0

Kundër: 17

Abstenim: 0



Nuk kalon projekt-buxheti i propozuar nga Kryetari i Komunës z.Ragip Begaj, sepse nuk mori vota, 17 ishin kundër edhe asnjë abstenim. Kalojmë të propozimi i dytë, b.) projekt-buxheti i propozuar për vitin 2019-2021 nga anëtarët e Kuvendit, PDK,LDK,LVV, ju lutem kush është për?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 0

U aprovua projekt-buxheti për vitin 2019-2021 i propozuar nga partitë opozitare PDK,LDK,LVV

Mbledhja përfundoi në ora: 20:03

Procesmbajtësja:

Verë Linda Gashi



Kryesuesi i Kuvendit:

Rrahim Morina

